

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
BALFIN HOSPITALITY SH.P.K  
RRUGA DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3, KATI 9, AP.NR.74, TIRANË, SHQIPËRI  
NUIS: M11327018A

VENDIM  
I  
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 30.03.2021, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **BALFIN HOSPITALITY** sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L81507052H (më tej referuar si "Shoqëria"), me adresë Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 9, ap.nr.74, Tiranë, Shqipëri, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia Administrative Nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 21, Ap.Nr.163, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L81507052H, përfaqësuar nga Administratori Znj. Ledia Telhai, shtetase shqiptare, e lindur më 24.08.1982, në Çlirim, Kolonjë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.030828934, dhe me numër personal I25824084W., - zotëruese e 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj, (**referuar edhe si: Ortaku i Vetëm**);

Znj. Ledia Telhai e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit të mbledhjes.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesën e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË;
- II. TË NDRYSHME

\*\*\*\*\*

Duke kaluar në diskutimin e çështjes në të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja të Shoqërisë për investime që do të kryejë, kërkohet financimi i saj me një shumë prej 100,000 EUR (njëqind mijë euro), Financimi do të jepet në formën e kontributit në kapitalin e Shoqërisë, i cili nga 1,000 LEK (një mijë lekë), do të zmadhohet në 100,000 EUR (njëqind mijë euro) ose kundërvlerën e Leke sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 29.03.2021 (1 Euro = 123.27), për një rritje kapitali në shumën 12,327,000 Leke (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzetë e shtete mijë lekë) duke e çuar kapitalin në një vlerë totale prej 12,328,000 Leke (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzetë e tete mijë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. TË MIRATOJË ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË **BALFIN HOSPITALITY SH.P.K.**, (NUIS: M11327018A) ME 12,327,000 LEK (DYMBËDHJETË MILION E TREQIND E NJËZETË E SHTETE MIJË LEKË) ("ZMADHIMI I KAPITALIT");
- B. ZMADHIMI I KAPITALIT DO TË NËNSHKRUHET DHE SHLYHET TËRËSISHT NGA ORTAKU I VETËM NË PARA.
- C. KAPITALI I SHOQËRISË PAS ZMADHIMIT NGA 1,000 LEK (NJË MIJË LEKË), DO TË BËHET 12,328,000 LEKË (DYMBËDHJETË MILION E TREQIND E NJËZETË E TETE MIJË LEKË).

- D. TË AUTORIZOJË PËRDORIMIN E KAPITALIT TË INJEKTUAR PËR INVESTIME TË PARASHIKUARA NGA SHOQËRIA.  
E. TË AUTORIZOJË ADMINISTRATORIN NË DETYRË TË SHOQËRISË, PËR TË KRYER TË GJITHA APLIKIMET E NEVOJSHME ME QËLLIM REGJISTRIMIN E KËTIJ VENDIMI PRANË QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT, PERSONALISHT OSE NËPËRMJET AUTORIZIMIT TË PERSONAVE TË TJERË PËR KËTË QËLLIM.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "BALFIN HOSPITALITY" SHPK mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.


\* \* \* \*

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË  
BALFIN HOSPITALITY" SHPK**

ORTAK I VETËM  
BALFIN REAL ESTATE & HOSPITALITY Sh.p.k.,

  
Znj. Ledja TELHAI

SEKRETARI

  
Z. Bers HADO

